



Qafa-Galeria No. 15
10000 Prishtinë
Kosovë

T/F +381 38 213 227
E info@qkk-rks.com
W www.qkk-rks.com

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE 2017

- 2 **HYRJE**
- 2 **AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS**
Sukseset në festivale
Anëtarësimi në SEE Cinema Network
Marrëveshje bashkëpunimi me GjirafaVideo
Premierat gjatë vitit 2017
- 5 **PJESËMARRJA NË TREGJE TË FILMIT**
Berlinale 2017
Cannes 2017
Beldocs Market
Annecy
Balkan Film Market
TIFFCOM në Tokio
- 9 **PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE**
Les Arcs në Francë
Rotterdam Lab në Holandë
When East Meets West në Trieste, Itali
Cineuropa, Belgjikë
Marrëveshja me FAMU Pragë, Çeki
Marrëveshja me EAVE Paris, Francë
Memorandumi me Fondin e Filmit Rajonal - Balkan Cinema Cities
Ceremonia e European Film Awards në Berlin, Gjermani
Delegacioni nga Turqia
- 13 **KONKURSI**
Takimi në përkujtim të Faruk Begollit – Ikonës së kinematografisë
Komisioni i Vizionimit të Përhershëm
- 17 **KOMISIONI I VIZIONIMIT TË PËRHERSHËM**
- 18 **BERLINALE PRESELECTION**
- 18 **PROJEKTET NË ZHVILLIM**
- 18 **PLANI 2018**

Qendra Kinematografike e Kosovës, si institucion me atributet e autoritetit qendror për kinematografi, ka për objektiv realizimin e politikave në fushën e kinematografisë që pasqyrojnë interesin publik.

Viti 2017 shënon një vit të suksesshëm për këtë institucion, që e karakterizojnë ngjarjet e shumta, si pjesëmarrja shumë më e gjerë e QKK-së në tregje të filmit, pjesëmarrja më e madhe e filmave në festivale të kategorisë 'A', nënshkrimi i shumë marrëveshjeve në të mirë të filmbërësve dhe zhvillimi e realizimi i shumë projekteve filmike.

AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS

Sukseset në festivale

Sivjet Kosova ka pasur suksese të jashtëzakonshme në festivale ndërkombëtare, duke qenë e pranishme në shumë festivale të kategorisë 'A', gjë që tregon për një zhvillim të shpejtë të filmave kosovar. Këtë vit filmi 'T'padashtun' nga Edon Rizvanolli, propozimi i Kosovës për Oscars, pati premierën botërore në Karlovy Vary International Film Festival, festival ky i kategorisë 'A' dhe një ndër festivalet më të vjetra në botë. Pastaj i njeiti film vazhdoi shfaqjen në festivale tjera të kategorisë 'A' si Cairo International Film Festival, International Film Festival në India Goa, e në shumë festivale e vende të tjera. Pastaj filmi debutues i regjisores Blerta Zeqiri 'Martesa', që pati premierën në Tallinn Black Nights Film Festival, gjithashtu festival i kategorisë 'A', nga ku triumfoi me dy çmime, çmimi i kritikës 'Fipresci Award' si dhe çmimi special për ansamblin më të mirë të aktorëve. Ndërsa filmi 'Rooftop Story' nga Gazmend Nela, pati premierën në Montreal World Film Festival si dhe filmi i shkurtër 'Një Muaj' nga Zgjim Terziqi, u dha premierë botërore në Cairo International Film Festival.



Anëtarësimi në SEE Cinema Network

Këtë vit, QKK mori pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të South Eastern Europe CINEMA NETWORK, ku edhe u shënua një fillim i ri pasi që Kosova u pranua si anëtare e saj.

SEE Cinema Network e themeluar në vitin 2000, është rrjet i shteteve të Evropës Juglindore, që synon zhvillimin e bashkëpunimit mes profesionistëve të filmit dhe shteteve anëtare të saj, duke mbështetur zhvillimin e bashkëprodhimeve ndërkombëtare dhe prodhimin e filmave të shkurtër. Qëllimet kryesore janë promovimi dhe zhvillimi i industrisë filmike kombëtare të secilit vend pjesëmarrës, për të forcuar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me anëtarët e rrjetit.

Me pranimin në SEE, projekteve filmike kosovare iu krijohen mundësi të barabarta me projektet e rajonit, ku mund të aplikojnë për zhvillim të filmit të metrazhit të gjatë artistik dhe për subvencionim të filmave të metrazhit të shkurtër, ndërsa në të ardhmen pritët që SEE të kthehet në një fond ballkanik të bashkëprodhimit.



Marrëveshje bashkëpunimi me GjirofaVideo

Një mundësi tjetër e jashtëzakonshme për filmat e mbështetur nga QKK ishte edhe arritja e marrëveshjes me Gjirofavideo, ku tani e tutje qytetarët e Kosovës do të kenë qasje në shikimin e filmave online, që ky institucion financon, duke qenë në favor të interesit publik dhe në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në filmat e Kosovës.

Në GjirofaVideo mund t'i shihni ekskluzivisht 9 filma shqip, shumica prej të cilëve janë fitues të çmimeve të ndryshme ndërkombëtare, ndërsa pritët që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe me filma të tjerë vitin e ardhshëm.

Filmat që tani më janë pjesë e kësaj platforme janë: 'Ballkoni' nga Lendita Zeqiraj, 'Kolona' nga Ujkan Hysaj, 'Krom' nga Bujar Alimani, 'Ferdonija' nga Gazmend Bajri dhe Shkurte Dauti, 'Ne të tre' nga Blerta Basholli, 'Çlirimi' nga Burim Haliti, 'Cheers' nga Norikë Sefa, 'Përfaqimi' nga Lulzim Guhelli dhe 'E kuqja' nga Gazmend Nela. Deri më tani rreth 30,000 persona i kanë shikuar filmat në platformën online.

Premierat gjatë vitit 2017

- Filmi i metrazhit të gjatë 'T'padashtun' me skenar dhe regji nga Edon Rizvanolli pati premierën ndërkombëtare në festivalin e kategorisë 'A' - Karlovy Vary International Film Festival
- Filmi i metrazhit të gjatë 'Rooftop Story' me skenar nga Gazmend Nela & Arian Krasniqi dhe regji nga Gazmend Nela pati premierën botërore në festivalin e kategorisë 'A' – Montreal World Film Festival
- Filmi i metrazhit të gjatë 'Martesa' me skenar nga Blerta Zeqiri & Keka Kreshnik Berisha dhe regji nga Blerta Zeqiri pati premierën botërore në festivalin e kategorisë 'A' - Tallinn Black Nights Film Festival.
- Filmi i gjatë 'Everything is Broken Up and Dances' me skenar dhe regji nga Nonny Geften pati premierën kosovare në PriFest.
- Filmi i metrazhi të gjatë 'Eho' nga Dren Zherka pati premierën rajonale në PriFest.
- Filmi dokumentar i gjatë 'Me dasht', me dasht', me dasht" nga Ilir Hasanaj pati premierën kombëtare në DokuFest.
- Filmi i shkurtër 'Një Muaj' nga Zgjim Terziqi pati premierën botërore në festivalin e kategorisë 'A' në Cairo International Film Festival.
- Filmi i shkurtër 'Once Upon a Time' nga Ekrem Rrahmani pati premierën kombëtare në PriFest.
- Filmi i shkurtër 'Tisa' me skenar nga Afrim Muçaj dhe regji nga Valter Lucaj pati premierën rajonale në PriFest.
- Filmi i shkurtër 'Gardhi' nga Lendita Zeqiraj pati para-premierën në Francë.

OKK këtë vit ka pasur përfshirje shumë të madhe në tregjet e filmave ndërkombëtar ku përveq atyre që është prezente zakonisht, si në Berlinale dhe Cannes, këtë vit ishte pjesë edhe e Beldocs në Serbi, Annecy Film Festival në Francë, Balkan Film Market në Shqipëri dhe TIFFCOM në Tokio.

Berlinale 2017

Qendra Kinematografike e Kosovës në fillimvit, pas përgaditjeve rreth festivalit Berlinale, ishte e pranishme në European Film Market – të festivalit prestigjioz siç është Berlinale.

Këtë vit, OKK pati shtandin e përbashkët me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë ku u promovuan filmat më të ri të shtetit të Kosovës si dhe të Shqipërisë. Aty u promovuan filmat kosovar në të gjitha fazat e zhvillimit (para-produksion, në-produksion, pas-produksion, të përfunduar dhe të lansuar) duke paraqitur një gamë të gjerë të filmave të vitit 2016-2017.

Përveq takimeve që pati në këtë treg dhe promovimit dorë më dorë të filmave që ishin gati për shfaqje si dhe të atyre që do të jenë gati së shpejti, OKK gjithashtu krahas Market Screenings organizoi shfaqje private të tre filmave të mbështetur nga OKK: filmit 'T'padashtun' nga Edon Rizvanolli, 'Rooftop Story' nga Gazmend Nela dhe 'Home Sweet Home' nga Faton Bajraktari. Këto shfaqje private ishin të dedikuara për producentë të huaj, programerë të festivaleve, agjentë të shitjes, distributor si dhe përfaqësues të fondeve.

Në Berlinale gjithashtu u nënshkruan dy marrëveshje me OKK-në. Memorandumi i mirëkuptimit me EAVE, me qëllim të bashkëpunimit në ofrimin e edukimit audiovizual, për qytetarët e Kosovës, në platformën European Audiovisual Entrepreneurs (EAVE), si dhe Memorandum Interesi të bashkëpunimit me Fondin e Filmit Rajonal (Regional Film Fund) Balkan Cinema Cities.



Qendra Kinematografike e Kosovës ka vazhduar prezencën me pavijon në tregun e filmit Marche Du Film në Cannes, i cili është një prej tregjeve më të mëdha në botë, duke ndarë pavijonin bashkë me QKK-në e Shqipërisë. Aty u promovuan filmat e fundit kosovar në kategori dhe faza të ndryshme të zhvillimit, si dhe u mbajtën shumë takime me partnerë ndërkombëtar të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të mëdha ndërkombëtare dhe producentë e distributor të ndryshëm.

Gjatë kësaj kohe, përveq përfaqësuesve nga QKK pati edhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës, nga Kosova Film dhe artistë të tjerë që kishin organizuar takime të ndryshme.

Në Festivalin e Cannes u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit mes Shoqatës së Producentëve të Filmit të Maqedonisë (MZFP) dhe Shoqatës së Producentëve të Kosovës, që do të shërbej në zhvillimin e marrëdhënieve dhe mbështetjen në fushën e industrisë së filmit.

Ky partneritet afatgjatë, ka për synim të përgjithshëm promovimin e industrisë së filmit dhe zhvillimin e kinematografisë së dy shteteve.

Maqedonia së fundmi është anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Producentëve të Filmit (FIAPF) dhe gjithashtu do të ndihmoj Kosovën në rrugën për anëtarësim në FIAPF.



Beldocs Market 2017

Në edicionin e 10-të të festivalit Beldocs, në Beograd, këtë vit mori pjesë edhe drejtori i QKK-së Arben Zharku, ku prezentoj filmat e fundit dokumentar të mbështetur nga QKK. Filmat siç ishin 'Daullet e Rezistencës' nga Mathieu Jouffre, 'Ferdonija' nga Gazmend Bajri dhe Shkurte Dauti si dhe 'Trapped by Law' nga Sami Mustafa, të cilët edhe u paraqiten në katalogun e Beldocs Market 2017.



Annecy Film Festival

QKK sivjet për herë të parë, mori pjesë në tregun e festivalit Annecy International Animation Festival në Francë, ku në bashkëpunim me festivalin kosovar të animacionit Anibar dhe Ministrinë e Kulturës, patën mundësinë të shpalosin të rejtat në fushën e zhvillimit të animacionit në Kosovë. Duke qenë pjesë e një ndër festivaleve më të mëdha ndërkombëtare të filmit të animuar, ky ishte një hap i suksesshëm në lidhje me forcimin e industrisë kosovare të animacionit.

Qëllimi i këtij përfaqësimi ishte promovimi i filmave të animuar ndërkombëtarisht dhe rrjetëzimi i filmbërësive kosovar me industrinë e animacionit. Në qershor të këtij viti, në Annecy u promovuan animatorët e pavarur kosovar, studiot e animimit dhe festivali i filmit të animuar në Kosovë, Anibar.



Balkan Film Market

Ky ishte viti i parë që QKK e Shqipërisë organizoi Balkan Film Market, tregun balkanik për lidhje të bashkëpunimit mes shteteve të rajonit. QKK ishte e pranishme në këtë treg me një delegacion prej rreth 30 filmbërësve, që ishin pjesë e lidhjeve të kontakteve me filmbërësit ballkanik. QKK planifikon që të merr pjesë në BFM edhe vitin që vjen.



TIFFCOM

Kosova për herë të parë ishte pjesë e tregut TIFFCOM, aleatët e festivalit të madh Tokyo International Film Festival, ku në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Japoni pati rastin të prezentoj industrinë e filmit kosovar në Japoni.

Japan Content Showcase (TIFFCOM) është treg i madh i filmit, TV, muzikës dhe animacionit. Sivjet ishin pjesë 371 ekspozues, ndër ta 208 nga Japonia dhe 163 nga shtetet tjera. Të pranishëm me pavijon ishin edhe shtetet e Amerikës Latine, Rusia, Kazakistan, Libani, Lituania, India, Zvicra.



Qendra Kinematografike e Kosovës viteve të fundit është përkujdesur me intenzitet të lartë në avancimin e producentëve kosovar duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me tregun e bashkëprodhimit të festivalit evropian të njohur Les Arcs European Film Festival në Francë, me Rotterdam Lab, pjesë e International Film Festival Rotterdam në Holandë si dhe me When East Meets West, e cila do të mbahet në fillim të 2018-tës në Trieste.

Këto bashkëpunime do të vazhdojnë gjatë vitit 2018, pasi që ndihmojnë zhvillimin e producentëve në arenat ndërkombëtare duke e parë shumë të nevojshme avancimin e tyre dhe filmbërjen në Kosovë.

Gjithashtu, QKK i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit sa më të madh të bashkëpunimeve ndërkombëtare. Me këtë rast janë hartuar drafte të bashkëprodhimit ndërkombëtarë me Bullgarinë, Kroacinë dhe Turqinë, marrëveshje këto të cilat pritet të nënshkruhen në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Në të njëjtën kohë është duke u punuar draft propozimi për anëtarësim në Eurimages.

Drejtori i QKK-së, këtë vit ka qenë i pranishëm në dy Asamblетë Gjenerale të European Film Promotion, ku QKK është anëtare, duke ruajtur komunikimin me të gjitha qendrat e filmit evropian dhe bashkëpunimin më të thellë me qendrat homologe rajonale.

Les Arcs European Film Festival në Francë

Në fundvit të 2016-ës, 4 filmbërës përfituan nga marrëveshja e QKK-së dhe Les Arcs, duke qenë pjesë e tregut të madh të bashkëprodhimit në Francë, ku të pranishëm ishin: Shkumbin Istrefi, Besnik Krapci, Bujar Kabashi dhe Yll Çitaku. Ndërsa sivjet, pjesë e ekipit që shkuan në Les Arcs përveq drejtorit të QKK-së, Arben Zharkut, ishin edhe producentët Vjosa Berisha dhe Yll Uka.

QKK është shumë e interesuar të ruaj këtë marrëveshje edhe në vitet në vazhdim pasi që është mundësi e jashtëzakonshme për lidhje të kontakteve si dhe për avancim të producentëve.

Rotterdam Lab në Holandë

Rotterdam Lab është punësoria për producentët në zhvillim, me të cilët QKK ka lidhur marrëveshje, duke mbështetur producentët e ri të jenë pjesë e kësaj punësorie dhe të kenë rastin të prezantojnë projektet e tyre filmike. Këtë vit përfitues nga kjo marrëveshje ishin dy producentët: Casey Cooper Johnson dhe Yll Uka.

When East Meets West në Trieste, Itali

QKK ka arritur këtë vit marrëveshje edhe me When East Meets West, i cili është forum i bashkëprodhimit me fokus vjetor në Evropën Lindore dhe Perëndimore. Ky forum ndihmon producentët të identifikojnë fonde të ndryshme dhe fonde alternative, si dhe ndihmon në mundësitë e distribuimit në rajonet që kanë më shumë vëmendje, gjithashtu, lehtëson në procesin e bërjes së politikave midis territoreve në fokus, në mënyrë që të nxiten bashkëprodhime të reja ndërmjet industrive që ende nuk janë të lidhura mirë.

Edicioni i vitit 2018 do të mbahet në Trieste, 21 deri 23 janar, ku do të jenë pjesë filmbërësit: Fatmir Spahiu, Shkumbin Istrefi, Bujar Kabashi, Ujkan Hysaj, Blerim Gjoci dhe Besnik Krapci.

QKK edhe në vitin 2017 ka vazhduar bashkëpunimin me Cineuropa, për promovimin e filmave kosovarë në botë përmes Newsletters, të cilat Cineuropa i shpërndanë dhe përmes artikujve për filmat kosovar.

Cineuropa është magazina më e madhe e industrisë së filmit, e cili i dha QKK-së dukshmëri të madhe ndërkombëtare, pasi që ka databazë tejet të pasur të industrisë së filmit në botë. QKK përmes newsletter që dërgon çdo muaj, ishte e pranishme në të gjitha mediumet ndërkombëtare.

Marrëveshja me FAMU Pragë, Çeki

Po vazhdon Memorandumi i Mirëkuptimit mes shkollës së filmit dhe televizionit të Akademisë së Arteve të bukura në Pragë – FAMU dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Qendrës Kinematografike të Kosovës, për bashkëpunimin në ofrimin e mundësisë së edukimit audio-vizual për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Bursa e plotë që ndahet nga Ministria e Kulturës, iu jep mundësi filmbërësve që të studiojnë në programin Bachelor (në rast se e flasin gjuhën çeke) dhe në programin Master në drejtimet: regji, skenar dhe kamerë (drejtor fotografie).

Akademia e Arteve të Bukura FAMU në Pragë është themeluar në vitin 1947 duke qenë kështu një ndër shkollat më të vjetra në botë, dhe sipas gazetës Hollywood Reporter është shkolla numër një në Evropë dhe e njëmbëdhjeta në botë. Të diplomuar nga kjo shkollë janë shumë regjisor dhe skenarist të njohur ndërkombëtarisht, si fitues të çmimeve Oskar ose laureat të festivaleve ndërkombëtare të filmit. Ndër të tjerë aty kanë studiuar edhe Milos Forman, Emir Kusturica etj.

Ky vazhdim i marrëveshjes u nënshkrua vitin e kaluar dhe sivjet përfitues i bursës është studenti i Fakultetit të Regjisë – Noar Sahiti, i cili tashmë ka filluar studimet pranë FAMU-së.

Deri më tani dy student kosovarë Dritëro Mehmetaj dhe Noar Sahiti e gëzojnë bursën nga MKRS, të cilët po vazhdojnë studimet në programin Master të kësaj shkolle, ndërsa studentja Norikë Sefa ka qenë përfituesja e parë e kësaj marrëveshje.



QKK, sivjet në Berlinale ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me EAVE. EAVE është trajnim profesional për zhvillimin e projekteve filmike dhe për krijimin e kontakteve mes producentëve nga e gjithë bota. Ky Memorandum zgjat për tri vjet dhe përmes saj përfitojnë producentët kosovar, të cilët pranojnë në këtë trajnim.

Kjo platformë është themeluar në vitin 1988 për t'i bashkuar producentët nga vendet e ndryshme të botës, me synimin e lehtësimit të marrëdhënieve për bashkëprodhim. EAVE ka për qëllim kontributin në krijimin e rrjeteve të fuqishme të kontakteve, të cilat do të forcojnë prodhimin e pavarur në të gjithë botën. Ky është një trajnim intenziv për një vit, i ndarë në tri punëtori. Përfituesi i parë nga kjo marrëveshje ishte producenti Besnik Krapci.



Memorandumi me Fondin e Filmit Rajonal – Balkan Cinema Cities Qendra Kinematografike e Kosovës sivjet në tregun e Berlinales, ka nënshkruar Memorandum Interesi të bashkëpunimit me Fondin e Filmit Rajonal (Regional Film Fund) i quajtur Balkan Cinema Cities.

Ky bashkëpunim do të ofroj mundësi të zhvillim të përbashkët ekonomik në fushën e filmit dhe në krijimin e marrëdhënieve të ngushta ndërmjet organizatave që mbështesin projekte filmike, qyteteve, producentëve dhe distributorëve. Të dyja palët do të iniciojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin ndërmjet industrisë së filmit, shoqatave të biznesit dhe qyteteve, për të inkurajuar dhe promovuar përparësitë e përbashkëta dhe rezultatet e dëshiruara nga sektori i filmit dhe për të identifikuar mundësitë për bashkëpunim.

Në bazë të këtij Memorandumi, do të bashkëpunohet në organizimin e takimeve mes filmbërësve, producentëve dhe përfaqësuesve të tjerë të filmit. Do të organizohen seminare, punëtori dhe forume që t'i informojnë filmbërësit për mundësitë e financimit të projekteve të tyre në rajon.

Qëllimi i këtij Memorandumi është të hapë marrëdhëniet organizative për një kornizë pune ndërmjet QKK-së dhe BCC-së, për të inkurajuar dhe përmirësuar mundësitë e prodhimit të veprave audiovizuale në territoret e tyre dhe për të gjetur interes të përbashkët për bashkëpunim.

Ceremonia e European Film Awards në Berlin, Gjermani


QKK është patron në European Film Awards dhe kështu ishte e pranishme në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të EFA, e cila njihet si Oscars i Evropës. Në këtë ngjarje prezent ishin: drejtori i QKK-së, Arben Zharku dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.

Njëherit vlen të përmendet që gjatë këtij viti në EFA me propozim të drejtorit të QKK-së, janë anëtarësuar 8 filmbërës kosovar në Akademinë prestigjioze të Filmit Evropian. Anëtarët e ri janë: Astrit Kabashi, Adriana Matoshi, Trim Musliu, Faton Bajraktari, Yll Uka, Valon Bajgora, Edon Rizvanolli, Visar Krusha.



Delegacioni në Turqi dhe anasjelltas

Gjatë këtij viti, QKK është interesuar në zhvillimin e raporteve Kosovë – Turqi me çrast delegacioni kosovar i përbërë nga drejtori i QKK-së Arben Zharku dhe sekretari i përgjithshëm i MKRS-së, Veton Firzi udhëtuan për në Ankara dhe Stamboll ku patën takime me Ministrin e Kulturës së Turqisë dhe me përfaqësues të fondeve të filmit. Gjithashtu delegacioni turk vizitoi Kosovën dhe festivalin PriFest.



Në muajin maj janë bërë të gjitha përgaditjet e fundit për prezentimin të projekteve aplikuese përpara jurisë vlerësuese. Gjithashtu në fund të muajit maj, saktësisht me 30 maj, është mbajtur prezentimi i projekteve të metrazhit të shkurtër dhe një ditë më pas janë shpallur vendimet e jurisë.

Juria vlerësuese e përbërë nga: Jahi Jahiu, Ilir Kabashi, Adil Olluri, Rebeka Qena, Florent Mehmeti, Veton Nurkollari, Eshref Durmishi kanë vendosur të mbështesin këto projekte:

Në kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtër artistik janë mbështetur:

‘Klithmë’ me skenar nga Korab Lecaj dhe Hazir Haziri, regji nga Korab Lecaj dhe producent Besar Zahiti.

‘Zona’ me skenar nga Armend Ismajli, regji nga Astrit Kabashi dhe producent Granit Limani.

‘Nanë’ me skenar dhe regji nga Valbona Jashari dhe producent Jetmir Zenelaj.

‘Ajo’ me skenar dhe regji nga More Raça dhe producent Sunaj Raça.

‘Liria e Zgjedhjes’ me skenar nga Semira Latifi, regji nga Birol Urcan dhe producent Agron Berisha.

Në kategorinë e filmit dokumentar janë mbështetur:

‘Aktorët e Kanës’ me skenar dhe regji nga Mentor Spahiu dhe producent Izet Morina.

‘Avenge’ me skenar dhe regji nga Marija Zidar dhe producent Latif Hasolli.

‘Urtësia’ me skenar dhe regji nga Bujar Berisha dhe producent Berat Kryeziu.

Në kategorinë zhvillim skenari janë mbështetur:

‘Hotel Slavia’ me skenar nga Besart Sllamniku dhe producente Edona Reshitaj. ‘Në kërkim të Venerës’ me skenar dhe regji nga Norikë Sefa dhe producent Besnik Krapu.

‘Lëkura e Dashit’ me skenar dhe regji nga Dren Zherka dhe producente Getoarë Mulliqi.



Në fillim të muajit qershor është mbajtur prezentimi i dytë përpara jurisë të projekteve që kanë aplikuar në konkursin e projekteve të metrazheve të gjata. Me datën 3 qershor është mbajtur prezentimi ndërsa me datën 5 qershor janë shpallur fituesit. Juria vlerësuese për projektet e metrazhit të gjatë artistik, debutant dhe koproduksion minor, e përbërë nga: Isa Qosja, Sevdije Kastrati, Bernd Buder, Zeynep Atakan, Artur Tahiraj, Dritan Huqi, Ramadan Musliu, pasi shqyrtuan projektet e paraqitura në konkurs, vendosën t'i mbështesin këto projekte:

**Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë –
artistik janë mbështetur 3 projekte:**

'Hana' me skenar nga Fadil Hysaj, regji nga Ujkan Hysaj dhe producent Kushtrim Koliqi.
'Mbylle Derën' me skenar dhe regji nga Parta Kelmendi dhe producent Mirsad Lushtaku.

'Kodra e Diellit' me skenar dhe regji nga Blerim Gjoci dhe producent Blerim Gjinovci.

**Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë artistik – debutant është
mbështetur projekti filmik:**

'Familja' me skenar dhe regji nga Durim Kryeziu dhe producent Bardhyl Bejtullahu.

**Në kategorinë e metrazhit të gjatë artistik – Koproduksion Minor, juria vendosi
të mbështes 3 projekte:**

'Nji prej nesh' me skenar dhe regji nga Ergys Meta dhe producent Agron Kryeziu.

'Bolero në vilën e pleqve' me skenar nga Lindita Jaupaj - Fejzaj dhe Spartak Pecani,
regji nga Spartak Pecani dhe producent Adrian Morina.

'Happiness' me skenar dhe regji nga Borjan Zafirovski dhe producente Vjosa Berisha.

Në 10 vjetorin e vdekjes së ikonës të kinematografisë kosovare, Faruk Begolli, OKK organizoi takimin përkujtimor për të afërmit, miqtë dhe të gjithë ata që vlerësojnë të arriturat e këtij aktori e regjisor të madh. Ky organizim është i pari i këtij lloji duke ndjerë nevojën që të mos harrohen njerëzit që kanë kontribuar dhe kanë rritur vendin tonë artistikisht. OKK planifikon që të vazhdoj me organizime të tilla, për të vlerësuar punën e artistëve dhe për t'u siguruar që veprat e tyre kinematografike nuk do të harrohen.



Edhe këtë vit, QKK dërgoi propozimin kosovar për Akademinë më të madhe të filmit Oscars, ku edhe sivjet si çdo vit që nga kualifikimi i shtetit të Kosovës për propozim, u vendos nga komiteti selektues të shtynë përpara filmin e regjisorit debutant 'T'padashtun' nga Edon Rizvanolli. Komiteti selektues ishte i përbërë nga: Astrit Kabashi (kryesues), Antoneta Kastrati, Visar Morina, Doruntina Basha, Arben Bajraktaraj, Ilire Vinca dhe Zymber Kelmendi. Ky film ishte në konkurrencë me dy filma tjerë të mbështetur nga QKK, filmi 'Rooftop Story' nga Gazmend Nela dhe 'Eho' nga Dren Zherka.

Komiteti selektues vendosi që filmi i cili do të përfaqësoj Kosovën si propozimi zyrtar për konsiderim në kategorinë 'Filmi më i mirë i huaj' të jetë filmi 'T'padashtun' nga Edon Rizvanolli, një dramë e cila merret me pasojat dhe traumat e shkaktuar nga lufta e vitit 1999 në Kosovë. Filmi trajton ngjarjen e një adoleshenti i cili jeton me nënën e tij kosovare në Amsterdam dhe që rikthimi i traumave të nënës së tij ia rrotullojnë botën. Ky komitet u shpreh: 'Pas shikimit të filmave konkurrues, për këtë vit, për përfaqësim të Kosovës në Oscar, komiteti selektues shpreh kenaqësinë, si për numrin e filmave, po ashtu edhe për kualitetin artistik të tyre. Të tre filmat, në veçoritë e tyre, sjellin rrëfime filmike, të trajtuara nga perspektiva shumë interesante dhe autoriale. Megjithatë, me shumicë votash, komiteti u përcaktua për "T'padashtun", si filmi përfaqësues i Kosovës për këtë vit në Oscar.'



Qendra Kinematografike e Kosovës, përkatësisht Këshilli Drejtues i QKK-së, këtë vit ka formuar Komisionin e Vizionimit të përhershëm, i cili do të angazhohet në dhënien e lejës për shfaqje publike të gjithë filmave që prodhohen në Kosovë.

Në bazë të Ligjit për Kinematografi, neni 9, par. 9.1. dhe 9.2 Komisioni i Vizionimit ka të drejtë të jep leje për shfaqjen publike të filmit sipas kategorive, të cituar:

”9.1. Për çdo film vendës apo të huaj që synohet të shfaqet publikisht, para se të ketë shfaqjen e parë në Kosovë, distributori, përkatësisht shfaqësi duhet të merr lejen për shfaqjen publike të filmit.

9.2. Lejen nga paragrafi i mësipërm, e jep Komisioni i Vizionimit i QKK.”

Komisioni i Vizionimit pritet të luaj rol shumë të rëndësishëm në krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për publikun e të gjitha moshave si dhe parandalimin e shfaqjes së filmave që nxisin urrejtje etnike, raciale, religjioze etj.

Anëtarët e Komisionit të Vizionimit të emëruar nga QKK janë: Veton Nurkollari, drejtor artistik i festivalit DokuFest, Linda Gusia, sociologe, Imer Mushkolaj, publicist & aktor, Birol Urcan, regjisor, dhe një person ad-hoc, i cili caktohet nga QKK, i ndryshëm për secilin film.



Këtë vit OKK pati kënaqësinë të prezentoj para selektorëve të Berlinale 5 filma kosovar, të cilët u shfaqën në Maqedoni bashkë me filmat tjerë të rajonit.

Filmat që u shfaqen me shpresën dhe dëshirën që të jenë pjesë e edicionit të ardhshëm të festivalit prestigjioz Berlinale ishin: 'Fusha e Mëllenjave' nga Arzana Kraja, 'Njeriu i dosjeve' nga Ismet Sijarina, 'Qiej të Trazuar' nga Anton Ndreca, 'Një tregim Prishtine' nga Burbuqe Berisha dhe filmi dokumentar 'Me dasht, me dasht, me dasht' nga Ilir Hasanaj.



PROJEKTET NË ZHVILLIM

Përveq 10 premierave të filmave të mbështetur nga OKK, shumë projekte tjera janë në faza të ndryshme të zhvillimit. Gjatë këtij viti kanë filluar xhirimet rreth 20 filma të metrazheve të ndryshme, prej të cilëve, disa janë ende duke xhiruar e të tjerët janë në post-production, ndërsa të gatshëm për shfaqje janë 13 filma, që kanë pasur premierën ose që presin ta kenë.

Filmat e gatshëm për shfaqje janë: 'T'padashtun' nga Edon Rizvanolli, 'Rooftop Story' nga Gazmend Nela, 'Gjumë dhe Dashuri' nga Arsim Haliti, 'Gardhi' nga Lendita Zeqiraj, 'Ura' nga Valmira Hyseni, 'Ncuk, ncuk, ncuk' nga Visar Arifaj, 'Once upon a time' nga Ekrem Rrahmani, 'Kosovo Dogs' nga Blerdi Malushi, 'Me dasht, me dasht, me dasht' nga Ilir Hasanaj, 'Year of the Monkey' nga Vladimir Blazevski, 'Sons of Kosovo' nga Gilles Coton, 'Një Muaj' nga Zgjim Terziqi dhe 'Martesa' nga Blerta Zeqiri.

PLANI PËR 2018

Për vitin 2018, OKK planifikon futjen në funksion të Rregullores për lehtësirat financiare, të cilat do të tërheqin investime të huaja në Kosovë, në fushën e industrisë së filmit, rregullore kjo që inkurajon dhe u hap rrugën investorëve të huaj për të xhiruar në Kosovë.

Poashtu do të lobohet për anëtarësimin e Kosovës në Euroimages si dhe në Creative Europe, këto dy platforma shumë fitimprurëse dhe të rëndësishme për vendin tonë dhe kinematografinë kosovare, me qëllimin e zhvillimit sa më të madh të industrisë tonë. OKK vitin e ardhshëm do të hartoj marrëveshjet e bashkëpunimit me Bullgarinë, Kroacinë dhe Turqinë, gjë që do të rrit bashkëpunimin e Kosovës me këto shtete.

Gjatë vitit 2018 shpresojmë që të hyj në funksion edhe Rregullorja e Ministrisë së Kulturës për sponzorizime, që do të jetë edhe një mundësi më shumë në gjetjen e fondeve alternative për filmbërësit kosovar.